

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 01.10.2026		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. B. Prot. 74	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.NR.74
Data:30.06.2026

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) neni 40, paragrafi 40.2 pika (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe nenit 25, paragrafit 2 pikës 2.3 së Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr. 50 të datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën **30.06.2026**, miratoi:

VENDIM
PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DRAFT KORNIZËS AFATMESME
BUXHETORE (KAB) 2027-2029

I

Me këtë vendim miratohet në parim Draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Periudhën 2027-2029

II

Draft Korniza Afatmesme Buxhetore përmban kufijtë fillestar buxhetor të të gjitha burimeve të financimit, përfshirë grantet qeveritare dhe planifikimin e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2027, si dhe vlersimet buxhetore për vitin 2028 dhe 2029.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Periudhën 2027-2029 ku paraqiten lista e projekteve në mënyrë të detajuar, prioritetet e tanishme dhe afatmesme.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në vebfaqen e komunës.

Kryesues i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 01.07.2026		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 75	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.75
Data:30.06.2026

Në bazë të nenit 12 të ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040 si dhe nenit 51 pika 2.9 të statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

I

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt i datës 15.06.2026 me nr protokoli 129/26, Për Miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

II

Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për shërbime publike e Ferizajt, Kryetari si dhe Kuvendi i Komunës së Ferizajt.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 01.07.2026		
Nr. Orgv Org. Jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 76	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNES
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.NR.76
 Data:30.06.2026

Në bazë të nenit 12 të ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040 si dhe nenit 51 pika 2.9 të statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për plotësim ndryshimin e vendimit me nr.76 i datës 31.07.2025, me anë të të cilit është aprovuar memorandumi i bashkëpunimit në mes OJQ-së, Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve "Shtëpia ime"-Ferizaj

I

Me anë të këtij vendimi plotësohet-ndryshohet vendimi me nr 76 i datës 31.07.2025 vetëm sa i përket nenit IV, ku i ipet në shfrytëzim e gjithë parcela 638-0 Z.K.Zaskok për organizatën në fjalë në mënyrë që fondet e përfituara nga OJQ e huaja të inplementohen në zgjerimin e objektit dhe punime tjera në parcelën 638-0 Z.K.Zaskok.

II

Të gjitha pikat tjera të vendimit 76 të datës 31.07.2025 që nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdesen Drejtoria e Urbanizmit Ferizaj, Kryetari dhe Kuvendi i Komunës së Ferizajt

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

 Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Danë: 01.07.2026		
Nr. Org. / Org. jed: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 77	Nr. Faqe / Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.77
Data: 30.06.2026

Në bazë të nenit 12 të ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040 si dhe nenit 51 pika 2.9 të statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr:50 i datës 30.04.2026

I

Me anë të këtij vendimi plotësohet-ndryshohet vendimi me nr:50 i datës 30.04.2026, vetëm sa i përket qmimit fillestar te ankandit.

II

Qmimi fillestar caktohet 100 € (euro), për tërë vitin kalendarik, për parcelat e cekura në nenin I të vendimit me nr:50 i datës 30.04.2026.

III

Të gjitha pikat tjera të vendimit 50 të datës 30.04.2026 që nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdesen Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit Ferizaj, Kryetari dhe Kuvendi i Komunës së Ferizajt

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Datë / Izdane: Date / Dana: 01.07.2026

Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 78 Nr. Faqeve. 2
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

01.Nr.78
Data:30.06.2026

Në bazë të nenit 12 të ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040, nenin 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 6 pika 1.2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenin 5 pika 1.3, neni 13, neni 21 pika 1.3, neni 25 pika 1 dhe 6 të rregullores (qrk) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 571-0 Z.K.Nekodim.

I

Ngastra kadastrale 571-0 z.k.Nekodim me sipërfaqe prej 10m², pronë e komunës së Ferizajt, i ipet në shfrytëzim kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike-SH.A. (KEDS), me numër identifikues 810799364, me adresë në Prishtinë, "Bill Clinton", Bulevardi Nr.5 Republika e Kosovës.

II

Kordinatat e pjesës së ngastrës të cekur në nenin I të këtij vendimi janë:

Nr	y	x	z
1	7514258.452	4690320.627	603.974m
2	7514262.809	4690320.011	604.011m
3	7514262.501	4690317.833	603.894m
4	7514258.144	4690318.448	603.991m

III

Pjesa e ngastrës kadastrale e përshkruar në nenin I të këtij vendimi I ipet KEDS-it SH.A, me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e një trafe në fshatin Nekodim.

IV

Afati për dhënie në shfrytëzim i pjesës së ngastrës së cekur më lartë është afatgjatë prej 99 vite.

V

Pjesa e ngastës kadastrale e përshkruar në nenin I ipët me kompensim, shuma e kompensimit është 1 (një) euro në muaj për 1m², në total për të gjithë sipërfaqën prej 10 m² është 10 (dhjetë) euro në muaj, mënyra e pagesës së qirasë përcaktohet me marrëveshje, e njejta mund të paguhet çdo muaj apo një herë në vit për gjithë vitin kalendarik.

VI


Autorizohet Kryetari i Komunës së Ferizajt që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të lidhë kontratën me fituesin.

VII

Për realizimin e këtij vendimi obligohet drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në operativ kadastral pas plotësimit të kushteve ligjore, ndarjes së parcelës dhe nënshkrimit të kontratës.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

